



Antisemitizmi në teologjinë e krishterë

Description

Rosemary Radford Reuther

Theology Today, Nr. 4, January 1974, f. 366-381

“Refuzimi i hebrenjve bazohen në refuzimin e Mesias...[por] hebrenjtë kanë qenë gjithnjë rrenegat të Zotit, kështu që refuzimi dhe vrasja e Jezusit është kulminimi i paracaktuar i kësaj historie të ligë të njerëzve të ligë...Në këtë mënyrë, në teorinë e krishterë, hebrenjtë u bënë të mallkuarit e përhershëm, jashtë kufirit të njerëzimit dhe historisë së sotshme, e ruajtur deri në fund të kohërave në një hapësirë negative të zemërimit hyjnor dhe mjerimit njerëzor”

Antisemitizmi në Krishterim nuk mund të trajtohet as si një shtesë aksidentale dhe jo e qenësishme dhe as si thjesht një produkt konfliktesh pastërtisht sociologjike midis kishës dhe sinagogës. Në rrënjët e tij, antisemitizmi është zhvilluar në krishterim nga antijudaizmi teologjik. Në teologjinë e krishterë, antijudaizmi qëndron si krahu i majtë i kristologjisë. Kisha dëshironte të provonte se Jezusi ishte Krishti i premtimit mesianik hebre, ashtu siç paraqitej në shkrimet hebraike. Kjo kërkonte zhvillimin e një polemike kundër traditës hermeneutike hebraike të asaj kohe, e cila e mohonte këtë interpretim. Ky mohim shkaktonte një përgjigje nga Krishterimi, e cila ishte e paracaktuar që të tregonte se Judaizmi, i cili mohonte statusin mesianik të Jezusit, ishte vetë në një status të përjashtuar, kështu që autoriteti i tij mesimdhënes (teaching authority) në këtë temë mund flakej plotësisht. Është prej kësaj lidhjeje midis midrashit kristologjik dhe atij antijudaik që ne hasim në krishterim atë union intim midis “besimit dhe vëllavrasjes (fratricide)”^[1]

|

Forma e këtij argumenti antijudaik është ajo e një *midrashi* mbi shkrimet hebraike. Literatura antijudaike e ka mbajtur këtë formë fillestare përmes etërve të Kishës, madje deri edhe në mesjetë.^[2] Me fjalë të tjera, argumenti antijudaik ka lindur si një “traditë dëshmish”^[3]. Me këtë dëshirojmë të

nënkuptojmë përqëndrimin e teksteve provë nga “Dhjata e Vjetër”. Kjo ishte forma më e hershme e mësimin dhe predikimit të krishterë; një formë që ekzistonte para shkrimit të Dhjatës së Re, atëherë kur Dhjata e Vjetër, kristologjikisht e interpretuar, ishte Bibla e kishës së krishterë. Kjo tregon sërish se argumenti antijudaik ka lindur si krahu i majtë i kristologjisë. Tradita e teksteve provë nga Bibla hebraike, që provonin se Jezusi ishte Mesia i prituri i këtyre shkrimeve, ka pasur, si krah të saj të majtë, një koleksion paralel tekstesh që provonin se statusi i diskretituar i interpretimit rabinik, i cili refuzonte midrashin kristologjik, provonte në të vërtetë statusin e refuzuar të *bashkësisë fetare* që refuzonte këtë interpretim të krishterë të shkrimeve të Dhjatës së Vjetër. Kjo nuk u ndalua thjesht me të provuarin e njëfarë faji të veçantë të liderëve fetar të kësaj bashkësie për vdekjen e Jezusit. Ajo u degëzua menjëherë në diskutime që synonin të provonin paaftësinë e mësuesve të bashkësisë hebraike për të lexuar në mënyrë të duhur shkrimet e shenjta. Po ashtu diskutimet synonin që të provonin, gjithashtu, statusin e diskretituar të ligjit të tyre fetar, adhurimit, madje edhe të historisë së kaluar të tyre, deri tek Moisiu. Historia hebraike u nda në dy gjysma, duke provuar se në qëllimshmërinë hyjnore ka ekzistuar gjithnjë njerëz të vërtetë të besimit, të cilët ishin njerëzit e vërtetë të premtimit, kundër njerëzve të rënë dhe të pabinduar, të cilët nuk i janë bindur asnjëherë Zotit dhe as kanë dëgjuar profetët. Njerëz të cilët që nga fillimi kanë mohuar apo vrarë profetët dhe prej të cilëve ishte e pritshme të mohonin *dhe madje të vrisnin* Mesinë, shëlbyesin e premtuar të traditës profetike, kur ai të shfaqej. Ky ishte një kulm logjik i një historie të ligë. Kisha ishte trashëgimtarja e njerëzve të vërtetë të premtimit, bashkësia shpirtërore e besimit, ndërsa “hebrenjtë”, d.m.th. bashkësia fetare e mbledhur rreth tempullit dhe mësuesve rabinikë, që mohonin midrashin kristologjik të kishës, ishin trashëgimtarët e historisë së ligë të pabesisë, apostazisë dhe vrasjes. Mbi qendrën kombëtare dhe atë të kultit të bashkësisë në Jeruzalem u derdh jo vetëm mohimi, por edhe zemërimi hyjnor, duke i ndjekur ato në ekzil dhe së fundmi deri në Ditën e Gjykimit, si një ndëshkim (retribution) i duhur për pikën kulmore të kësaj historie të ligë.

Kjo temë shfaqet në formën e saj fillestare që në parabolën e vreshtit të ungjijve sinoptik, e cila është zhvilluar në mënyrë më të plotë nga Ungjilli sipas Mateut. Sipas kësaj parabolole Mbreti (Zoti) e lë vreshtin e tij (Izraelin) në duart e disa vreshtarëve (hebrenjtë), duke dërguar herë pas here shërbëtor (profetët) për të kontrolluar se si po shkonin gjërat. Por vreshtarët e pabesë i rrahën, gurëzuan, *madje edhe vranë* në mënyrë konstante shërbëtorët. Më në fund, mbreti dërgoi birin e tij, duke supozuar se ata do ta respektonin djalin e mbretit. Por ata e vranë në vend atë, duke besuar se në këtë mënyrë do të bëheshin pronarë përfundimtar të vreshtit. Me fjalë të tjera, ata nuk kanë asnjë të drejtë karshi vreshtit. Ata janë vetëm vreshtarë, jo bij. Çfarë do ti bënte i zoti i vreshtit atyre kur të vinte? Ai do të vij dhe do ti shkatërroj vreshtarët dhe “do t’ua besojë vreshtin vreshtarëve të tjerë, të cilët do t’i japin prodhimet në kohën e vet”. Në këtë moment tek Mateu vjen menjëherë teksti i mirënjohur i “gurit”, i cili ka qenë shumë i rëndësishëm për mirdashin e hershëm kristologjik: “Guri, që ndërtuesit e nxorën të papërdorshëm, u bë guri i qoshes. (Mateu 21:42; Psalmet 118:22-23).

Kjo traditë duhet të jetë formuar shumë herët. Pali, i cili shkruante rreth viteve pesëdhjetë (e.r.s.), e merrte për të mirëqenë shkrirjen e këtij teksti me atë të gurit “që Zoti ka vënë në Sion”. (Romakëve 9:30-33; Isaia 28:16) si një gur “pengese për Izraelin” (Isaia 8:14-15).^[4] Kjo ide është përfshirë me idenë se Izraeli i ka vrarë “gjithnjë” profetët. Ky model armiqësie është shtrirë dhe ndaj misionarëve të krishterë, si vazhdimësia e linjës profetike, të cilët janë marrësit aktual të kësaj trashëgimie të armiqësisë “hebraike” ndaj profetëve. Së fundmi, këto ide të cilat përputhen me justifikimin e “refuzimit” të Izraelit, janë lexuar së bashku me idenë se Zoti ka përzgjedhur një popull tjetër midis xhentilëve (johebrenjve).

“Sepse ju, o vëllezër, u bëtë imituesit e kishave të Perëndisë që janë në Jude në Jezu Krishtin, sepse edhe ju keni vuajtur nga ana e bashkëkombasve tuaj të njëjtat gjëra, sikurse edhe ata kanë vuajtur nga

Judenjtë, të cilët e vranë Zotin Jezus dhe profetët e tyre, dhe na përdoqën edhe ne. Ata nuk i pëlqen Perëndia, dhe janë armiq me të gjithë njerëzit, duke na penguar që t'u flasim johebrejve që ata të shpëtohen, për ta mbushur vazhdimisht masën e mëkateve të tyre; por zemërimi arriti mbi ta më në fund". (1 Thesalonikasve 2:14-16)

Tema se Izraeli ka vrarë gjithnjë profetët është përsëritur vazhdimisht në ungjijtë sinoptikë (d.m.th. Ungjilli i Mateut, Markut dhe ai i Lukës). Në Veprat e Apostujve, Stefani e arrin kulmin rrëfimit të tij të apostazisë së Izraelit me gjykimin:

O njerëz qafëfortë dhe me zemër e veshë të parrethprerë, ju gjithnjë e kundërshtoni Frymën e Shenjtë; ashtu siç bënë etërit tuaj, ashtu bëni edhe ju. Cilin nga profetët nuk e përdoqën etërit tuaj? Ata vranë edhe ata që paralajmeronin ardhjen e të Drejtit, për të cilin tani ju jeni bërë tradhtarë dhe vrasës" (Veprat 7:51-52).

Në një masë të mirë Stefani hedh sugjerimin, po ashtu, se hebrenjtë nuk e kanë zbatuar asnjëherë ligjin, ndoense më parë ai kishte mbajtur qëndrimin sipas së cilit ligji hebraik nuk ishte ligji i vërtetë i Zotit, duke qenë se urdhëresat që Zoti kishte pasur si synim që të jepte në Sinai nuk u dhanë për shkak të adhurimit që hebrenjtë i bënë viçit të artë. Si pasojë, hebrenjtë kanë një ligj të rremë të Moisiut dhe nuk kanë qenë asnjëherë populli i besëlidhjes së Zotit. Ligji nuk iu dha atyre në Sinai dhe u ruajt për popullin e krishterë në Ditët e Fundit.

Teksti kulmor mbi Izraelin renegat, si linjë e atyre që vranë profetët dhe që nuk e dëgjuan asnjëherë fjalën e Zotit, vjen prej traditës "Q". Tek Mateu kjo është përdorur si pikë kulmore e kapitullit të "mallkimeve" kundër Farisenjve:

"Mjerë ju, o skribë dhe farisenj hipokritë! Sepse ndërtoni varrezat e profetëve dhe zbukuroni monumentet e të drejtëve, dhe thonë: "Po të kishim jetuar në kohën e etërve tanë, nuk do të kishim bashkëpunuar me ta në vrasjen e profetëve". Duke folur kështu, ju dëshmoni kundër vetes suaj, se jeni bijtë e atyre që vranë profetët. Ju e kaloni masën e etërve tuaj! O gjarpërinj, o pjellë nëpërkash! Si do t'i shpëtoni gjykimin të Gehenas? Prandaj, ja unë po ju dërgoj profetë, dijetarë dhe skribë; ju disa prej tyre do t'i vritni dhe do t'i kryqëzoni, disa të tjerë do t'i fshikulloni në sinagogat tuaja dhe do t'i persekutoni nga një qytet në tjetrin, që të bjerë mbi ju gjithë gjaku i drejtë i derdhur mbi dhe, nga gjaku i të drejtit Abel, deri te gjaku i Zaharias, birit të Barakias, që ju e vratë ndërmjet tempullit dhe altarit". (Mateu 23:29-35).

Ky tekst ndiqet menjëherë nga ai i vajtimit mbi Jeruzalemin: "Jeruzalem, Jeruzalem, që i vret profetët dhe i vret me gurë ata që të janë dërguar!" dhe gjykimin se "shtëpia juaj po ju lihet e shkretë", e ndjekur nga parashikimi se tempulli do të shkatërrohej kështu që "nuk do të mbetet asnjë gur mbi gur që nuk do të rrënohet". Por, pjesa kulmore e këtij seksioni gjendet tek Mateu 27:25 ku njerëzit e Jeruzalemit kërkojnë vrasjen e Jezusit, duke ulëritur: "Le të jetë gjaku i tij mbi ne dhe mbi fëmijët tanë!". Në mënyrë dramatike ky është "veprimi" përfundimtar i asaj që është "parashikuar" nga historia e ligë e Izraelit renegat, d.m.th. vrasja e birit të mbretit, kësisoj "për ta mbushur vazhdimisht masën e mëkateve të tyre" (1 Thesalonikasve 2:16) dhe duke tërhequr mbi kokat e tyre hakmarrjen e Zotit për gjakun e të gjithë njerëzve të drejtë që nga fillimi i historisë, për të mos përmendur edhe martirët që do të vijnë më pas.

II

Natyrisht, ky diskutim antijudaik filloi si një konflikt sektar brenda vetë judaizmit. Nga njëra anë kemi sektin mesianik hebre (që më vonë do të quhej krishterim) i cili e konsideronte Jezusin e kryqëzuar si

Mesi, i cili e priste kthimin e tij si Biri i Njeriut dhe i cili i interpretonte shkrimet hebraike për të vërtetuar se profetët kanë parashikuar dhe mësuar vazhdimisht se Shpëtimtari i ardhshëm duhej të vuante, të kryqëzohej nga liderët zyrtar fetar dhe të ringjallej në ditët e tretë. Nga ana tjetër kemi bashkësinë fetare kryesore (mainstream) të Judaizmit, e mbledhur rreth tempullit dhe mësuesve rabinik, të cilët asnjëherë nuk e kanë vënë re këtë model profetik në shkrimin e shenjtë dhe as nuk kanë gjetur tek Jezusi karakteristikat e Mesisë. Rrënjët e këtij diskutimi qëndrojnë qartësisht në eksperiencën themelore të dishepujve për mësimin mesianik të Jezusit dhe të vdekjes së tij. Një eksperiencë që i bindi ata se në këto ngjarje “përmbysja kulmore e periudhave kohore” kishte ndodhur tanimë. Por, kjo eksperiencë e ringjalljes nuk i bindi asnjëherë bashkëfetarët e tyre.

Shpesh është thënë se hebrenjtë prisnin ardhjen një Mesie thjesht mishor, material apo nacionalist. Por ndarja midis materiales dhe shpirtërores i takon historisë së polemikës së krishterë kundër judaizmit. Judaizmi profetik nuk bënte një ndarje të tillë midis dimensionit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Ai priste që transformimi shpirtëror të merrte formën e një transformimi radikal dhe të dukshëm të historisë, që do të shfuqizonte të ligën dhe do të krijonte një situatë të re të Mbretërisë së Perëndisë. Midis ardhjes së Mesisë dhe asaj të Mbretërisë së Perëndisë nuk ekzistonte asnjë ndarje. “Dy ardhjet” janë një dhe e njëjta gjë. Për hebreun mesatar, i cili nuk ishte kapur nga pritshmëritë mesianike që rrethonin mësimin e Jezusit, e ripohuar si eksperiencia e ringjalljes, nuk kishte asnjë evidencë se një “kthim epokash” i tillë kishte ndodhur. Jezusi ishte thjesht një mësues mesianik, i vrarë nga një kombinim i turbullt i forcave politike lokale dhe atyre romake. Bota e ligë vazhdonte kursin e saj normal në mënyrë dukshëm të pandryshuar. Për të kuptuar se asnjë shpëtim nuk kishte ndodhur ishte e mjaftueshme që dikush të hidhte vështrimin jashtë dritares për të parë ushtarët romakë duke u turrur mbi njerëzit

Megjithatë, për të krishterët kthesa e madhe kishte ndodhur tanimë në një mënyrë të fshehtë dhe të mistershme, e padukshme për shikimin, ndonëse shumë shpejt qiejt do të hapeshin dhe Jezusi do të shfaqej me një ushtri engjëjsh për të zbuluar dukshëm se fitorja kundër ligësisë kozmike kishte ndodhur tashmë që në vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Kështu që, ata duhej të kërkonin në shkrimin e shenjtë (Dhjata e Vjetër) për të vërtetuar se ky model i përmbushjes mesianike është po i njëjti që ka qenë parashikuar dhe mësuar *gjithnjë* nga profetët. Për më tepër, ata duhej të tregonin se përgjigjja negative ndaj mesazhit të Jezusit ka qenë, gjithashtu, pjesë e të njëjtit mësim profetik, ashtu siç shfaqet ai tek Shkrimi i Shenjtë.

Fillimisht ky argument i dyanshëm funksiononte për misionin brenda Izraelit. Të bindur se vetëm ata ishin të aftë ti kuptonin shkrimet dhe përmbushjen përfundimtare të tyre në ato ditë të fundit të historisë botërore, të krishterët, në mënyrë jo të ndryshme nga sektarët mesianik dhe predikuesit baptist të asaj periudhe, vendosën që ta predikonin këtë si kuptimi i vërtetë i besimit biblik dhe që të bindnin vëllezërit e tyre “mosbesues” se ata kishin gabuar në mospranimin e Jezusit; se ata duhej të pendoheshin dhe ta pranonin Jezusin si guri i qoshes i besëlidhjes së shpëtimit. Njësoj siç esenët që besonin se çdokush i cili nuk bëhej pjesë e bashkësisë së tyre dhe e interpretimit që ata i jepnin ligjit dhe historisë ishte jashtë Izraelit të vërtetë dhe premtimit për shpëtim, ashtu edhe të krishterët vepronin si një sekt mesianik hebre që deklaronte se dikush mund të merrte pjesë në besëlidhjen e vërtetë dhe në premtimin e saj vetëm duke besuar në Jezusin si guri i qoshes.

Ishte ky interpretim i Jezusit si “guri i qoshes” të besëlidhjes së shpëtimit, të cilin ndërtuesit (liderët e judaizmit normativ) e refuzuan, “i cili u bë guri i qoshes” (guri i qoshes i besëlidhjes së vërtetë të shpëtimit), që e bëri mësimin e krishterë të panegociueshëm që nga fillimi, të paktën për sa i përket judaizmit tradicional. Me fjalë të tjera, ky interpretim i Jezusit si guri i qoshes ishte “pengesa” themelore që më pas do të shkaktonte shkëputjen e të krishterëve nga bashkësia fetare hebraike, sepse ai

nënkupton zëvendësimin e një themeli të ri të besëlidhjes për ato që i përkisnin traditës. Nënkuptimeve të kësaj ideje iu deshën gjenerata të tëra arrirë në ndarje të plotë sociale, por rrënjët e kësaj ndarjeje duhen parë si të pranishme që nga fillimi, në konceptin e “gurit të ri të qoshes”. Si pasojë, ky predikim i kuptimit të shkrimeve të shenjta (nga të krishterët) haste në kundërshtim të plotë nga institucionet fetare kryesore (mainstream) hebraike, veçanërisht nga farisenjtë të cilët ishin elita midis interpretuesve rabinikë të mësimin tradicional hebraik.

Në Dhjatën e Re ishin farisenjtë ata që i zëvendësuan priftërinjtë e tempullit dhe “skribët” duke u paraqitur si “djemtë e këqinj” të polemikës së krishterë kundër liderëve normativ të Judaizmit. Sapo kisha e hershme doli për të predikuar mesazhin e saj, së pari në Palestinë e më pas në Diasporë, ishin këta predikues që konsideruan se tradita e krishterë ishte hedhur poshtë dhe predikuesit e krishterë u përjashtuan nga të mësuarit e këtij interpretimi në sinagogë. Jo rallëherë ky përjashtim shoqërohej me goditje të rënda pas shpine, i cili ishte ndëshkimi standard që sinagoga zbatonte ndaj atyre që mbanin mësim disidente, veçanërisht ndaj atyre mësimeve që përçanin rendin e adhurimit në sinagogë.^[5] Urdhëri i vërtetë nga asambleja rabinike, që i ndalonte të krishterët të drejtonin adhurimin në sinagogë, u dha vetëm në vitin 90 (e.r.s.). Por është e mundur që ndëshkimet lokale të jenë zbatuar menjëherë në vende të ndryshme ku të krishterët përqeshin të predikonin mesazhin e tyre në sinagogë. Ndryshe nga çfarë thuhet zakonisht, ky urdhër duket se nuk i ka përjashtuar asnjëherë plotësisht të krishterët nga pjesëmarrja në mënyrë të qetë e adhurimeve në sinagogë. Kjo ishte diçka që të krishterët vazhdonin ta bënin në Antiokun e shekullit të katër, madje edhe më vonë^[6]. Ajo që solli ky urdhër ishte përjashtimi i mësuesve të krishterë nga drejtimi i shërbimit liturgjik në sinagogë, duke imponuar në këtë mënyrë atë që rabinët e konsideronin si një interpretim i gënjeshtërt i traditës.

Duke e parë veten të përjashtuar nga institucionet e zakonshme të bashkësisë hebraike, ana negative e hermeneutikës kristologjike filloi të ngurtësohej në predikimin e krishterë, duke ndryshuar nga një thirrje profetike për hebrenjtë që të konvertohen në një gjykim fiks dhe përfundimtar mbi hebrenjtë si një bashkësi e refuzuar – këtu termi “hebrenjtë” nuk nënkupton racën, por bashkësinë fetare; domethënë, bashkësinë fetare hebraike të mbledhur rreth lidërshiptit priftëror dhe rabinik dhe *midrashit* të shkollave rabinike që mohonte *midrashin* e bërë nga kisha.

Ky negativitet gjithnjë e në rritje u transformua nga një ngjarje e re dhe disi e papritur. Predikimi i krishterë, që refuzohej nga bashkësi hebraike, filloi të tërheq një numër të madh xhentilësh (joçifutësh), veçanërisht “ato që i druheshin Zotit”, të cilët ishin të tërhequr nga etika dhe monoteizmi hebraik dhe që ishin mbledhur rreth sinagogave, por që e shihnin ligjin hebraik si një barrierë për identifikimin e plotë me mesazhin e tij. Të familjarizuar me fetë e mistereve, që përqendroheshin në një zot-shpëtues që vdiste dhe ringjallej, karakteristikat kryesore të krishterimit, që ishin të papranueshme për hebrenjtë, nuk shkaktonin asnjë vështirësi për këta xhentilë.

Tekte në lidhje me verbërinë dhe ligësinë e liderëve të bashkësisë fetare normative hebraike lexoheshin jo vetëm në një dritë më të ashpër, si rezultat i mospërgjigjes së sinagogës ndaj predikimit të krishterë, por ato morën gjithashtu një shtrirje kompensuese. Ekspozimi i “mosbesimit të hebrenjve” tanimë vendosej së bashku me mesimin rreth përgjigjes pozitive të xhentilëve. Edhe ky element u përfshi në *midrashin* e Dhjatës së Vjetër dhe u paraqit si një mësim që ka qenë gjithnjë pjesë e saj dhe që ka qenë parashikuar nga profetët. Si rezultat i kësaj seri ndërveprimesh midis interpretimit të ngjarjeve historike dhe përgjigjes sociologjike ndaj interpretimit, arrijmë më në fund në atë model të ekzegjzës së Dhjatës së Vjetër që është karakteristike e ungjijve sinoptikë dhe librit Veprat e Apostujve, ku “refuzimi i hebrenjve” proklamohet së bashku me idenë e “përzgjedhjes së xhentilëve”. Të gjithë tekstet e vjetra profetike që flisnin për Izraelin si “drita e kombeve” dhe për “grumbullimin e

kombeve rreth Sionit”, që priteshin si pjesë e përmbushjes mesianike, ide të cilat tek profetët ekzistonin në një marrëdhënie të vazhdueshme dhe pozitive me shpëtimin e Izraelit, tanimë ishin përvetësuar nga kisha, por në një marrëdhënie negative në lidhje atë tani shihej si “Izraeli i vjetër”. Populli i “vjetër” i përzgjedhur është treguar i pabesë dhe është përjashtuar. Por Zoti po farkëton për veten e Tij një popull të ri nga mesi i xhentilëve, të cilët do të prodhojnë frytet e vërtetë të vreshtës. Përzgjedhja i është hequr hebrenjve për shkak të mëkateve të tyre, që arritën kulmin në refuzimin që ata i bënë Mesisë, dhe i ka kaluar popullit të ri që janë përzgjedhur nga “kombet” dhe që do të jenë bijtë e vërtetë të Zotit dhe trashëgimtarët e premtimit.

Me shumë gjasa, modeli hermeneutik e ka zanafillën brenda sferës së misionit ndaj xhentilëve, gjatë dy ose tre dekadave të mësimi oral, ndonëse kristalizimi në shkrim i tij në ungjijtë sinoptikë dhe në librin e Veprave të Apostujve ndodhi disa dekada më vonë. Gjithsesi, ky model ishte i njohur për Palin dhe me shuma gjasa ai nuk ka qenë krijuesi i tij, por vete ai i ndërtoi idetë e tij mbi ato paraardhësve të tij “helenist” të cilët filluan misionin ndaj xhentilëve[7].

Kjo traditë hermeneutike që shprehte ndarjen e krishterimit si populli i ri jashtë “Izraelit të vjetër” dhe në rrugë e sipër drejt xhentilizimit, u përfshi nga Pali dhe autori i Letrës drejtuar Hebrenjve dhe më pas ajo u transformua nga shkolla e Gjonit në një strukturë filozofike që kishte formën e dualizmave antropologjikë dhe kozmologjikë. Struktura u ndërtua duke shkrirë dualizmin midis “mishores” dhe “shpirtërores” të Filonit: ekzegjezë me dualizmin sektar mesianik midis “historikes” dhe “eskatologjikes”. Nga kjo shkrirje krijohet mundësia për ta interpretuar ndarjen midis Izraelit të “vërtetë” dhe atij “rrengat”, e cila e konsideron të parin si tejkalues dhe zëvendësues të të dytit, si historikisht ashtu edhe nga niveli moral dhe ontologjik. Sapo ky koncept origjinal i krishterimit si zëvendësimi eskatologjik i “Izraelit të vjetër” filloi të lexohej gjithnjë e më shumë mbrapa në histori, atëherë nga kjo ekzegjesë u zhvillua doktrina e “dy epokave”, ajo e vjetër dhe “mishore” e besëlidhjes së Moisiut dhe epoka e “re” shpirtërore e kishës. Lindja midis “mishores” dhe “shpirtërores”, historikja dhe eskatologjike, lexohet si një linjë midis dy epokave dhe dy bashkësive historike, por e mbushur me të gjithë absolutizmin e këtyre themeleve teologjike. Ajo që në Judaizëm kishte qenë një marrëdhënie dialektike, në Krishterim ishte shndërruar në një antitezë. Ky “historicizim i eskatologjikes” është i qenësishëm për llojin e shtrembërimit të mesazhit të krishterë që përfaqësohet nga antijudaizmi. Për pasojë, krahu i majtë antijudaik i Krishterimit mund të zgjidhet (resolved) vetëm përmes një rimendimi radikal të idesë së “ardhjes së Mesisë” si një linjë që ndan Judaizmin si “epoka e vjetër e Adamit të vjetër” nga Kisha, që ndan njeriun dhe historinë në momentin historik të jetës dhe vdekjes së Jezusit.

III

Tek Pali gjenden rrënjët e kësaj përfshirjeje të tëhuajzimit në dualizmin kozmologjik dhe antropologjik. Epoka e vjetër, ajo e ligjit të Moisiut, është parë si epoka e verbërisë dhe e ngurtësimit të zemrës. Vetë ligji është parë si një shprehje e kësaj epoke të njeriut adamik të rënë, që i korrespondon mbretërimit të pushteteve dhe principatave, ose siç i quan Pali “elementet e botës” (Kolosianëve 2:8, 20; Galatasve 4:3). Në Krisht ky mbretërim i fuqive djallëzore mbi historinë njerëzore, i ilustruar nga elementët e botës dhe nga ligji, janë thyer dhe njerëzimi është çliruar nga ndikimi i tyre. Por, hebrenjtë që refuzojnë ta pranojnë këtë hermeneutikë kristologjike janë ende nën pushtetin e njeriut të rënë. Madje në teologjinë e krishterë ata u bënë shprehja tipike e kësaj gjendjeje. “Hebrenjtë” u bënë njerëzit mishor dhe jashtë hirit hyjnor. Një perde kishte rënë mbi zemrat e tyre dhe e gjithë feja e tyre ishte vetëm ritual dhe rutinë, “një hipokrizi” pa virtytin e brendshëm apo fuqinë shëlbyese. Në kontrast me këtë i krishteri është “njeriu shpirtëror”, njeriu i besimit dhe hirit, i kuptuar sikur të jetë tanimë i pajisur me karakteristikat e “njeriut eskatologjik”, transcendent ndaj fuqive të fundme historike dhe shijues i “frytëve të para” të Mbretërisë së Perëndisë.

Në teologjinë e Gjonit, ky kontrast midis “dy epokave” është absorbuar në dualizmin midis mishores dhe shpirtërores. Kjo është kuptuar më shumë si një transcendencë vertikale se sa horizontale. Konflikti midis Izraelit të vërtetë dhe atij rrenagat u shndërrua në një konflikt midis njeriut mishor, së bashku me botën e ulët mishore, dhe njeriut shpirtëror, të bashkuar në besim së bashku me botën e “lartësuar” shpirtërore. Ndjekësit e Krishtit janë njerëzit shpirtërorë, të bashkuar (in communion) me botën “e lartësuar” shpirtërore, të cilët e kuptojnë botën e Zotit në mënyrë shpirtërore. “Hebrenjtë” janë njerëzit mishor që e interpretojnë gjithçka për së jashtmi. Ata nuk e kanë njohur asnjëherë Zotin sepse nuk kanë njohur Krishtin, kështu që as shkrimin e shenjtë nuk e kanë lexuar siç duhet, d.m.th. në mënyrë kristologjike. Ata i përkasin kozmosit të ulët dhe të rënë të “princit të kësaj bote”. Ata janë bijtë e djallit, dhe dëshira e tyre është të bëjnë vullnetin e atit të tyre (djallit), i cili që nga fillimi ishte një vrasës (Gjoni 8:43-47). Kështu që, si “verbëria” ashtu edhe armiqësia e hebrenjve ndaj Krishtit, njeriut shpirtëror, nuk bën gjë tjetër vetëm se shpreh “natyrën” e tyre të vërtetë. Ata janë bijtë e djallit, babait të gënjeshtreve. Ata janë pasqyrimet tipike të principit të tëhuajzuar të njeriut dhe kozmosit të rënë, i cili jo vetëm që refuzon të vërtetën, por edhe reagimi instiktiv i tij ndaj të vërtetës është ai i armiqësisë vrasëse. Kështu që, ishte si pasojë e natyrës së tyre që kur u shfaq njeriu shpirtëror, Biri i Zotit, këto bij të parimit djallëzor reaguan ndaj tij me armiqësi të papërzier dhe shpenzuan të gjitha energjitë e tyre për ta shkatërruar dhe vlarë atë. Pasi Gjoni vendosi këtë antitezë midis njeriut shpirtëror dhe “hebrenjve”, atëherë ai e lexon këtë marrëdhënie si diçka që do të vazhdojë midis bijve të Krishtit (të krishterëve) dhe sinagogës. Kështu që, në pasqyrimin e Jezusit konflikti midis hebrenjve dhe Jezusit nuk është thjesht një ngjarje e së kaluarës, por është bërë paradigma për të kuptuar marrëdhëniet e vazhdueshme midis kishës dhe sinagogës.

Temat themelore të traditës *Adversos Judaeos* u fiksuan brenda vetë Dhjatës së Re. Shkrimet antijudaike të etërve të kishës e konsoliduan, shtrinë dhe ashpërsuan këtë traditë. Fakti se shkrimet *Adversos Judaeos* të etërve të Kishës bazohen mbi koleksione të *midrashim*-ëve kristologjike dhe antijudaike të Dhjatës së Vjetër dhe në disa raste ato nuk përbëhen nga gjë tjetër vetëmse nga zinxhira të teksteve të tilla të arranzhuara në rend tematik[8], tregon se deri në çfarë mase është ndërtuar kjo traditë dhe se ajo vazhdon formën më të hershme of të bërit teologjii nga të krishterët[9].

Këtu do të përmbledhim në një formë shumë të shkurtër temat themelore të literaturës patristike antijudaike. Diskutimi i tyre përqendrohet rreth dy temave kryesore: refuzimi i hebrenjve me përzgjedhjen e xhentilëve dhe abrogimi i ligjit. Refuzimi i hebrenjve bazohej mbi mospranimin që ata i kishin bërë Mesisë, por, siç ndodh edhe në Dhjatën e Re, kjo është lexuar në retrospektivë në trashëgiminë e keqbërjes, e cila arriti pikën kulmore në këtë akt të fundit të apostazisë. Duhej treguar se

hebrenjtë kishin qenë gjithnjë rrenogat, kështu që mohimi dhe vrasja e Jezusit ishte pika kulmore e paracaktuar e kësaj historie të ligë të njerëzve të ligë. Kjo listë krimesh u zgjerua në shkrimet e etërve të kishës. Hebrenjtë jo vetëm që kishin refuzuar gjithnjë profetët dhe i kishin vrarë ata, por, duke filluar me adhurimin e viçit të artë, mund të dëshmohej se hebrenjtë që nga fillimi i kishin kthyer gjithnjë shpinën Zotit dhe kishin adhuruar idhuj. Kjo prirje për idhujtari nuk u ndal në Sinai. Përgjatë historisë pasuese, hebrenjtë e braktisën vazhdimisht Zotin dhe u turrën pas Baalëve. Të gjitha tekstet biblike kundër baalizmit gjurmoheshin për të provuar se hebrenjtë kanë qenë gjithnjë renegat dhe idhujtarë të pandreqshëm. Duke përdorur tekstet profetike atyre i atribuoheshin krimet më të rënda. Tuhej se hebrenjtë kishin qenë kanibal dhe se ia flijonin bijtë e tyre idhujve. Gjoni Kristostomi (John Chrysostom), sermonet kundër hebrenjve të të cilit përfaqësojnë retorikën ekstreme të kësaj tradite, e konsideronte historinë hebraike si një gjyq të zgjatur jo vetëm të idhujtarisë, por edhe të grykësisë. Tek Kristostomi hebrenjtë merrnin pamjen e figurave paranatyrore djallëzore me një oreks të pangopur për vesin, të dhënë pas çdo shthurjeje mishore dhe shpirtërore. Vetë ligji thuhet se i është dhënë hebrenjve jo si një shenjtë virtyti të veçantë, por thjesht për të mbajtur nën fre këtë prirje të pandreqshme të tyre për idhujtari dhe vese.

Shume prej etërve të kishës adoptuan skemën e historisë që vendos, para ligjit të Moisiut, një periudhë më të hershme fejeje universale shpirtërore, që i korrespondon mbretërisë së ligjit natyror në zemrat e njerëzve. Besohej se kjo periudhë ka ekzistuar gjatë kohës së patriarkëve dhe asaj ndërmjet krijimit të njeriut dhe përmbytjes universale të Noeut. Kjo ishte feja e vërtetë universale shpirtërore e Zotit, por ajo u eklipsua përkohësisht nga stadi më i ulët i fesë, i përfaqësuar nga ligji i Moisiut. Si pasojë, ligji filloi të përfaqësoj Rënien dhe dhënia e tij kishte si shkak ligësinë e veçantë të hebrenjve, për të cilët thuhej se kishin nevoj për kufizime shtesë për shkak të idhujtarisë dhe veseve të panatyreshme që ata morrën në Egjipt. Por tanimë, me Krishterimin, një racë e re heronjsh moral kishte dalë në dritë, kështu që ligji nuk ishte më i nevojshëm. Feja fillestare universale dhe shpirtërore e ligjit natyror ishte rivendosur në një formë të re dhe të përsosur. Kjo teori ishte veçanërisht e rëndësishme për Euzebin, por ajo është përmendur dhe aluduar në shkrime të tjera të ndryshme patristike.[10]

IV

Metoda hermeneutike për të provuar këtë rrëfim të historisë së ligë hebraike konsiston në ndarjen e krahut të djathtë nga ai i majtë i mesazhit profetik. Të gjitha përshkrimet negative, gjykimet dhe kërcënimet janë nxjerrë jashtë kontekstit dhe janë lexuar në një mënyrë monolitike si përshkruese të hebrenjve. Ana pozitive e mesazhit profetik, veçoritë e pendimit dhe premtimi i ardhshëm është konsideruar si diçka që nuk i aplikohet hebrenjve, por kishës. Heronjtë e Dhjatës së Vjetër u bënë linja e Kishës, ndërsa hebrenjtë kuptoheshin si një popull i dhënë pas apostazisë së pandreqshme, përgjatë periudhës së Dhjatës së Vjetër. Duke qenë se Kisha vepronte me një literalizëm biblik, i cili i konsideronte librat e Biblës si të shkruar nga Zoti, ose si shprehje të heroizmit të profetëve dhe heronjve të Dhjatës së Vjetër, atëherë nuk ndjehej nevoja që të shpjegohej sociologjikisht se si një dokument i caktuar ishte shkruar dhe ruajtur si shkrimi i shenjtë i bashkësisë së një populli të cilët nuk i kishin “dëgjuar asnjëherë profetët”. Duke e ndarë gjykimin profetik nga premtimi profetik përftohej një rrëfim i vazhdueshëm ligësie, si karakteristikë e popullit të Dhjatës së Vjetër, ndërkohë që ofrohej një panoramë e Kishës e cila kishte humbur krahun e majtë të autokritikës profetike. Në këtë mënyrë, antijudaizmi dhe triumfalizmi kishtar shfaqeshin si dy anë të të njëjtit bigëzim (bifurcation).

Në këtë histori të ligë të hebrenjve, krimi i fundit ishte vrasja e Mesisë. Në të vërtetë, kjo histori e së ligës u krijua nga apologjetët e krishterë në mënyrë që ti jepte këtij krimi një trashëgimi dhe shpjegim. Sapo kristologjia zhvillohet në doktrinën e plotë të besimit Nikeas, kjo filloi të shihej jo vetëm si vrasja e profetit të fundit, por si vrasja e vetë Zotit, krimi i zotvrasjes (deicide), i tradhëtisë dhe i *lése majesté* kundër sunduesit të universit. Për kriminele të këtij lloji asnjë mallkim (vituparation) nuk është

ekstrem, siç mund të shihet edhe në sermonet e Gjon Krisostomit, i cili flet në mënyrë konstante për hebrenjtë si djaj, për sinagogat e tyre bordello të djallit dhe për shpirtrat e hebrenjve si vendbanime të djajve.

Për shkak të këtij krimi të fundit hebrejtë janë përjashtuar në mënyrë të pakthyeshme nga mëshira hyjnore. Qyteteti i tyre është shkatërruar, vendet e tyre të kultit u shkatërruan për të mos u ndërtuar më, të gjitha privilegjet dhe shenjat e përzgjedhjes hyjnore u hoqën prej tyre. Ata u dërguan në robëri dhe ekzil në mes të armiqve të tyre në mënyrë për të mos iu ndarë mjerimi deri në fundin e kohrave. Në mënyrë të vazhdueshme, etërit patristik vërtetimin prej shkrimit të shenjtë se ndërkohë që robërimet e mëparshme në Egjipt dhe Babiloni ishin parashikuar për një kohë të kufizuar, robërimi i tretë është parashikuar që të mos ketë asnjë limit deri në fund të historisë. Marrëzisht, hebrenjtë ende vëzhgojnë horizontin duke pritur Mesinë, por Mesia ka ardhur tashmë dhe ata e kanë refuzuar atë. Nëse ata janë ende duke pritur ardhjen e ndonjë mesie tjetër, kjo do të thotë se ata janë duke shpresuar për ardhjen e Antikrishtit. Në të vërtetë, pretendimi i tyre i mosnjohjes së faktit që Mesia ka ardhur tanimë është thjesht një hipokrizi e pastër. Profetët i kanë treguar atyre çdo detaj të ardhjes së tij, kështu që ata zotërojnë çdo mjet të nevojshëm për ta njohur atë. Prandaj, pretendimi i tyre për paaftësi për të njohur Jezusi si Mesia i parashikuar është thjesht një pabesi e fundit e tyre, që reflekton në mënyrë të padyshimtë mosdashjen e tyre për tu kthyer nga rrugët e liga. Ata do të mbeten në një gjendje qortimi dhe mjerimi deri në fund të kohrave kur Jezusi do të kthehet në madhësi, në mënyrë që ata të njohin më së fundi gabimin e tyre. Në të vërtetë, rrethprerja nuk ishte dhënë atyre për asgjë tjetër vetëm se për këtë. Larg së qenuri një shenjë e përzgjedhjes dhe favorit hyjnor, siç ata marrëzisht mendojnë si pasojë e të qenit të tyre të fryrë nga një “krenari e kote për shkak të mendjes së tyre mishtore,” rrethprerja ishte dhënë nga Zoti sepse ai ishte paraprakisht në dijeni të statusit të tyre të mallkuar në histori. Rrethprerja shërben si një shenjë e Kainit përmes së cilit çdo hebre do të njihej nga të tjerët dhe rrjedhimisht do të përjashtohej nga kthimi në tokën e premtuar, veçanërisht nga qyteti i shenjtë i Jeruzalemit.

Në teorinë e krishterë, hebrenjtë u bënë të mallkuarit (damned) e përhershëm, jashtë sferës njerëzore dhe historisë në zhvillim e sipër, e ruajtur deri në fund të kohërave në një hapësirë negative të zemërimit hyjnor dhe mjerimit njerëzor. Nëse hebrenjtë pendohen dhe pranojnë Jezusin si Mesinë, atëherë me shumë gjasa ata do të falen të gjithë. Por shumica e etërve të kishës nuk e vinin shumë theksin mbi shpresën e Palit për konvertim dhe pajtim. Sidoqoftë, madje edhe për shkrimtarë të tillë si Agustini, të cilat theksojnë mesazhin e Romakëve 9-11 mbi konvertimin e ardhshëm të hebrenjve, kjo nuk lejonte asnjë përligje aktuale për hebrenjtë si të tillë. Sepse hebrenjtë si të tillë, bashkësia fetare që nuk pranon Jezusin si Krisht dhe ende beson se ka përzgjedhje, besim dhe bindje që duhet gjetur përmes Ligjit të Moisiut, nuk ka gëzim të tanishëm ose shpresë për të ardhmen, por vetëm mjerim dhe robëri të pafundëm brenda historisë dhe mallkim përfundimtar në fund të kohërave.

V

Kjo traditë antijudaike u zhvillua në një pikëpamje fikse diku midis periudhës apostolike dhe shekullit të katërt. Ajo përsëritej vazhdimisht në çdo sermon të krishterë, komentar biblik apo traktat teologjik që fliste për judenjtë. Duke qenë se Kisha vazhdonte të pretendonte historinë dhe shkrimet hebraike si të tyren si edhe Biblën dhe vazhdonte të shihte veten si trashëgimtare e përzgjedhjes së Izraelit, ishte e vështirë të predikojë ose të jepje mësim për ndonjë gjë pa qenë të detyruar që ti përmendje në një farë mënyre edhe hebrenjtë.

Në çerekun e parë të shekullit të katërt, Krishterimi u transformua nga një besim i persekutuar në një fe zyrtare të perandorisë. Ajo që më parë kishte qenë tradita armiqësore e një sektit të paligjshëm

(krishterimi) kundrejt religjonit prindëror të saj (hebraizmi) tashmë ishte bërë besimi zyrtar i fesë civile të perandorisë romake. Në më pak se pesëdhjet vjet krishterimi ortodoks e kishte ngritur veten në fenë e vetme të perandorisë. Besimi dhe praktika e paganëve, madje edhe e heretikëve u deklarua e paligjshme. Tempujt dhe kishat e tyre u shkatërruan ose u konfiskuan. Ekzistenca e tyre u ndalua. Ndaj hebrenjve situata ishte më e ndërlikuar. Tradicionalisht hebrenjtë kishin një status të mbrojtur në ligjin romak. Ata konsideroheshin si qytetarë romak dhe atyre i garantohej e drejta për të adhuruar dhe praktikuar ligjin e tyre si edhe normat drejtuese të bashkësisë së tyre. Megjithatë, teologjia e krishterë ndonëse kishte dekretuar mjerim për hebrenjtë nuk kishte dekretuar zhdukjen e tyre. Ajo e kishte lejuar ekzistencën e Judaizmit deri në fundin e kohërave, ndonëse në një status mjerimi, pikërisht në mënyrë që ata të vepronin si dëshmitarë përfundimtar të vërtetësisë së Kishës. Si pasojë legjislacioni kundër hebrenjve, që filloi të zbatohet nga perandorët romakë, ishte një pasqyrë sociale e kësaj teologjie.

Duke filluar që nga shekulli i katërt, bashkësia e hebrenjve u privua nga të gjitha të drejtat civile. Hebrenjve i ndalohej të mbanin poste civile apo ushtarake, të përfaqësonin vetveten në gjykatë, të ishin gjykatës apo juristë. Në një nga ligjet vetë ideja që një hebre të kishte autoritet mbi një të krishterë ishte quajtur si një “fyerje për besimin tonë”^[11] Martesat ndërftetare u konsideruan një krim kapital. Kisha i shtoi këtyre ligjeve civile edhe disa ligje të tjera kundër vëllazërimit social apo fetar. Ndonëse adhurimi i kryer nga hebrenjtë u lejua, gjithsesi në ligjin civil dhe në ligjin kanonik u bë çdo përpjekje për të ndaluar prozelitizmin dhe për të kufizuar adhurimin e hebrenjve në rrethaa sa më të ngushta të mundura. Prozelitizmi dhe konvertimi në Judaizëm ishte subjekt i ndëshkimeve të ashpra. Hebrenjtë ishin të ndaluar që të rrethprenin apo të zotëronin skllëvër të krishterë. Asnjë sinagogë nuk mund ngrihej dhe as të vjetrat të riparoheshin. Ligjet e Adrianit, që i ndalonin hebrenjve aksesin për në Jeruzalem mbetën në fuqi dhe *fiscus Judaicus* u rivendos për të nënshtruar çdo hebre ndaj një takse për kokë të veçantë. Duke qenë se hebrenjve i ishte ndaluar pozitat e favorshme në perandori, ata u detyruan të mbanin postin shkatërrimtar të mbledhësit lokal të taksave.

Në këto ligje, të cilat impononin një status të veçantë qortimi dhe shpërndarjeje mbi bashkësinë hebraike brenda botës së krishterë, vërehet një gjuhë poshtëruese klerikale. Në një nga ligjet e hershme të kanonit të Teodosit sinagoga përmendet me fjalën zhargon latine që do të thotë “bordello”, një fjalë që nuk ishte përdorur asnjëherë në ligjin romak për një vend adhurimi fetar.^[12] Hebrenjtë përmenden vazhdimisht nëpër ligje si një grup i urryer nga Zoti, që duhej konsideruar nga shoqëria e krishterë si të neveritshëm, madje djallëzor. Ligjet e ashpra me epitete negative dhe të ngarkuara teologjike. Thënë shkurtimisht, perandorët e krishterë nuk nxirrnin ligje (legislate) si sundimtarët shekullarë. Ata vepronin si mjete të kishës apo si shfrytëzues cinik të paragjykitimit, për përfitime politike. Me ligje të tilla perandorie kishte pak përfitime racionale sociale. Perandorët e krishterë flisnin si eksponentë të pikëpamjes teologjike të krishterë për hebrenjtë, duke vepruar në të drejtën e tyre si mbetë-priftërinj të perandorisë teokratike të krishterë.

Por psikologjia popullore e gjeneruar nga kjo pikëpamje për hebrenjtë, si armiq të Zotit dhe të Kishës së "Tij" prodhonte gjithnjë teprime që dhunonin madje edhe limitet e këtij diskriminimi ligjor. Turma të drejtuar nga murgj fanatikë pushtonin zonat e hebrenjve për të djegur apo konfiskuar sinagogat. Gjatë shekullit të katër dhe të pestë ndodhën fenomene të tilla si pagëzimet me detyrim, shpërbërja e riteve fetare hebraike, shpërthimet e dhunës në rrugë si edhe përjashtimi i tyre nga qendrat urbane, si p.sh. Aleksandria dhe Antioku. Perandorët nxirrnin në mënyrë të vazhdueshme ligje kundër këtyre tejkalimeve, por përpjekjet e tyre për të kërkuar shpagim për bashkësinë hebraike shpesh përballej me kundërshtimin e drejtpërdrejt të peshkopëve dhe "shenjtorëve" të krishterë.^[13] Ligjet perandorake përsërisnin qendrimin ligjor karshi Judaizmit si fe, por duke filluar nga shekulli i V perandorët u bënë gjithnjë e më shumë të pazotë për të zbatuar legjislacionin e tyre.

Në periudhën bizantine, vetë perandorët shkelnin periodikisht teoritë e tyre duke u përpjekur për të nxjerrë ligje në favor të konvertimit me dhunë. Kjo sillte si pasojë valë të tëra persekutimi të hebrenjve.

Por këto përpjekje dështuan, dhe perandorët shfuqizonin vazhdimisht legjislacionin e tyre.^[14] Sapo perandoria bizantine konsolidoi rendin e saj ekonomik dhe politik, statusi i hebrenjve u stabilizua në atë të një diskriminimi ligjërish të zbatuar kundër përparimit social, por atyre iu garantua statusi i mbrojtur për adhurimin e tyre brenda kësaj sfere të mohimit. Përpjekjet periodike për ti konvertuar hebrenjtë dështuan dhe valët periodike të dhunës të kryera nga popullata kundër hebrenjve ishin të përmbytura. Kështu që, shoqëria bizantine ofronte një pasqyrë sociale të stabilizuar të teorisë së krishterë të ekzistencës së hebrenjve, si ajo e një gjendje qortimi, ndonëse të mbrojtur brenda këtij statusi historik të mjerimit.

VI

Nga ana tjetër, në perëndim efektet sociale të kësaj trashëgimie e shprehjes teorike dhe ligjore morën një rrugë shumë më të gabuar dhe prodhuan një histori më ekstreme valësh paranoje, ikje për kokë turku dhe masakre. Arsyeja për këtë qëndron pjesërisht në faktin se në Perëndim strukturat politike dhe ekonomike të perandorisë u shkatërruan. Siqodoftë, legjislacioni i perandorisë u ruajt, i përfshirë në ligjin kishtar, si edhe recensimet e kanonit të Teodosiusit të bëra për shtetet barbare. Tradita e *Adversos Judaeos* vazhdoi të jetë norma ekzegjetike standarde e cila udhëhiqte sermonët dhe komnetarët biblikë. Shkatërrimi i rendit politik nënkuptonte se mjetet për të zbatuar diskriminimin ligjor kundër hebrenjve u bënë të disponueshme vetëm në mënyrë të parregullt. Natyrisht, peshkopët e krishterë luajtën një rol të ndryshëm në perëndim. Ata u bënë zëdhëndës për ligjet e vjetra, duke këmbëngulur tek princat dhe mbretërit barbarë që ata të vazhdonin të zbatonin këto ligje kundër hebrenjve. Papa në Romë ishte zbatuesi më konsekuent i legjislacionit të perandorisë së vjetër. Në Perëndim hebrenjtë ishin reduktuar sistematikisht në statusit më të ulët social dhe ekonomik, ndonëse mjerimi i tyre ishte i mbrojtur. Asnjë pogrom nuk ndodhi në territoret e papnore, por hebrenjtë mbetën të kufizuar në një nga getot më të mjerueshme në historinë evropiane deri në shpërbërjen e shtetit papnor në vitin 1870.^[15]

Në Evropë, shkatërrim i rendit ekonomik i lejoi hebrenjve, ndonëse përkohësisht, që të iknin nga ky status ligjor dhe ekonomik mjerimi, madje ata luajtën një rol kyç në ringjalljen e jetës ekonomike, sepse ata ishin të vetmin që mbanin kontakte me lindjen. Nga shekulli i VIII deri në shekullin e XI, hebrenjtë ishin katalizator të ringjalljes ekonomike dhe si të tillë ata vlerësoheshin nga princat dhe mbretërit, pavarësisht nga kundërshtimet e peshkopëve të krishterë. Por, nga ana tjetër, indoktrinimi i vazhdueshëm i një pikëpamjeje djallëzore për hebrenjtë, e cila depërtoi në nivelin popullor veçanërisht përmes dramave liturgjike të mbajtura në hapësira publike, prodhoi një gjendje urrejtjeje irracionale e cila shpërthente në dhunë, veçanërisht në raste fatkeqësish. Shpërthime të tilla dhunë nuk mund të

kontrolloheshin nga asnjë rend apo forcë ligjore, qoftë civile apo kishtarë. Drejtuesit e kishës luajtën një rol thellësisht ambivalent në këtë histori, duke këmbëngulur në të gjitha ligjet që diskriminonin hebrenjtë si dhe duke imponuar në mësimet e tyre teologjike mitin djallëzor për sa i përket hebrenjve. Këto liderë kishtarë u treguan të paaftë për të njohur mënyrën sipas së cilës mesimet dhe veprimet e tyre krijuan një mjedis në të cilin ndodhnin këto shpërthime dhune. Pozita e lidershit të Kishës kundrejt rezultateve të antijudaizmit teologjik kanë qenë e tillë sa që mund të përshkruhet si “dora e djathtë që nuk di se ç’bën dora e majtë” dhe ky vazhdon të jetë qëndrimi i kishës së krishterë kundrejt historisë së antisemitizmit në historinë e krishterë deri në ditët tona, pavarësisht nga Holokausti.

Në shekullin e XI kjo përzierje e paqëndrueshme shpërtheu në një seri masakrash të tmerrshme që ranë mbi bashkësinë hebraike në prag të çdo kryqëzate të mëpasshme. Kjo eksperiencë shpërthimesh të paarsyeshme vrasjesh masive kundër një grupi thelbësisht të padëmshëm (unoffending) prodhoi mite të reja antijudaike në formën e fantazive vetëjustifikuese të “vrasjeve rituale”, “helmimeve të puseve” dhe tradhëtisë shoqërore që pretendohet ishin bërë nga hebrenjtë. Pas kësaj rënieje të statusit, bashkësia hebraike u shpërbë në mënyrë të shpejt në gjendjen e demonizimit ekstrem, getizimit, poshtërimin përmes praktikave të tilla si veshja e detyruar e kësulave konike dhe e “simboleve hebraike” që në mesjetën e vonshme ishin fati i tyre në shoqërinë e krishterë. Krejtësisht e varur nga pushtetet politike, në mungesë të çdo të drejte të qenësishme vendbanimi në çdo zonë, bashkësia hebraike ishte bërë krejtësisht e cenueshme ndaj dhunës popullore nga poshtë dhe zhatjes apo përjashtimit nga lart. Kjo derisa Rilindja dhe shekullarizimi i shtetit i shpërbeu gradualisht format teorike dhe ligjore të botës së krishterë. Në toka të tilla si Rusia, modeli mesjetar vazhdoi deri në fillim të shekullit të XX. Madje edhe në Evropën perëndimore statusi i hebrenjve nuk u natyralizua si ai një qytetarisë së zakonshme deri pas revolucionit francez.[16] Kriza e fundit e përfaqësuar nga holokausti nazist tregoi se kjo pozitë ende vazhdon të qarkulloj thëllë në venat e Evropës perëndimore në shekullin e XX. Vazhdimësia e kësaj ngjarjeje me historinë e saj të mëparshme nuk duhet anashkaluar, pavarësisht nga adaptimi i mitit racial shekullar të antisemitizmit për mitin më të hershëm fetar.

VII

Në një masë të madhe historia e hebrenjve në botën e krishterë duhet parë si e udhëhequr nga shëmbëlltyra teologjike e krijuar në literaturën patristike *Adversos Judaeos*. Kjo nuk do të thotë se imazhi teologjik krijoi ngjarje historike në një vijë të drejtë, një marrëdhënie shkak-pasojë. Por ajo do të thotë se ky imazh siguroi strukturën teorike brenda së cilës duhet reaguuar dhe interpretuar të gjitha ngjarjet historike për sa kohë kjo teologji klasike mbetet ende në fuqi. Sipas kësaj teorie, hebrenjtë konsideroheshin si veçanërisht djallëzor në natyrë dhe pozitë, nën pushtetin negativ të zemërimit të Zotit përgjatë gjithë periudhës së krishterë. Kjo do të thoshte se sa herë që hebrenjtë iknin nga një status social mjerimi drejt një statusi pasurie apo pozitive drejtuese në politikë dhe kulturë, me shumë mundësi kjo do të konsiderohej si një fyerje ndaj identitetit të krishterë. Një sfidë implicite ndaj përzgjedhjes së krishterë që kërkonte, si krah të majtë të saj, statusin e qortuar të hebrenjve.

Nga ana tjetër, pikëpamja triumfaliste e Kishës dhe shoqërisë së krishterë, e kuptuar brenda kornizës së mesianizmit të përmbushur, nuk ka ofruar një strukturë interpretuese për kuptimin e fatkeqësive. Fatkeqësitë e përbashkëta nuk mund të konsideroheshin si të natyrshme dhe as mund të brendësoheshin nga Kisha në mënyrë të përbashkët (corporately). Sa me dukshme të ishte shkaku i fatkeqësisë, aq më tinëzar duhej të ishte shkaktari i saj. Hebrenjtë, si “Iloji” i armiqësisë djallëzore ndaj shpëtimit të krishterë ishin përcaktuar për të qenë koka e turkut për fatkeqësitë e të krishterëve dhe shpjegimi i gatshëm i mospërmbushjes së krishterë.

Përktheu: Rezart Beka

[*] Rosemary Ruether është diplomuar në Scripps College dhe Claremont Graduate School. Ajo është profesoreshë e teologjisë historinë në Universitetin e Hoëardit, Uashington, D. C., dhe profesoreshë e jashtme gjatë vitit 1973 në Divinity School të universitetit të Harvardit.

Referenca

[1] Ky është titulli i një libri të ardhëm rreth këtij subjekti, të shkruar nga autorja dhe që do të publikohet nga Harvard University Press në vitin 1974.

[2] Një përmbeldhje e disponueshme e këtyre veprave mund të gjendet A. L. Williams, *Adversos Judaeos* (Cambridge, 1935).

[3] See D. Plooi, *Studies in the Testimonies Book* (Amsterdam, 1932). Për një kritike të tezës së Rendal Harris se tradita e Dëshmive është në të vërtetë një libër, shih Barnabas Lindars, *New Testament Apologetic; The Doctrinal Significance of Old Testament Quotations* (Philadelphia: Westminster, 1961), pp. 13ff.

[4] Ibid., Lindars, pp. 169ff.

[5] See Douglas Hare, *The Theme of Jewish Persecution of Christians in the Gospel According to Mattheë* (Cambridge, 1967).

[6] Për shembull, tetë sermonët që Gjon Kristostomi (Chrysostom) predikoi në vitin 386-7 (e.r.s), u mbajtën për shkak se shumë të krishterë vazhdonin të ndiqnin adhurimet e sinagogës, sidomos në celebrimet fetare.

[7] See Marcel Simon, *St. Stephen and the Hellenists* (1958).

[8] Shih, p.sh., **tre librat** e dëshmisë së Qiprianit (Ante-Nicene Fathers, Vol. 5, pp. 507ff.) and Pseudo-Nyssa, *Testimonies Against the Jeës* (Migne, F.G., Vol. 46).

[9] Ndër shkrime të tjera madhore antijudaike janë: The Epistle of Barnabas; Justin's Dialogue with Trypho; Tertullian, In Ansëer to the Jeës; Hippolytus, Demonstration Against the Jews; Cyprian, Testimonies; Aphrahat, Three Homilies Against the Jeës; Ephraim the Syrian, Rhythm Against the Jews; Jacob of Serug, Homilies Against the Jews; Dialogue of Timothy and Aquila, and Dialogue of Athanasius and Zacchaeus; Pseudo-Nyssa, Testimonies; Chrysostom, Eight Homilies Against the Jews, and Demonstration Against Jews and Greeks; Isidore of Seville, Against the Jews; Augustine, In ansëer to the Jews; and John of Damascus, Against the Jews, concerning the Sabbath. Also Novatian, On Jewish Meats, and Eusebius, Demonstration of the Gospel and Preparation for the Gospel.

[10] Eusebius, Praeparatio Evangelica. Midis të tjerave, Tertuliani e përsërit këtë traditë në traktatin etij kundër hebrenjve.

[11] Law of Theodosius II, Jan. 31, 439; Novella III; Në lidhje me hebrenjtë, samaritanët, heretikët dhe paganët.

[12] Codex Theodosianus, ed. Mormnsen and Meyer (1905); 16,8.1: fjalat është conciliabulum.

[13] Për shembull, Teodosiusi në vitin 388 i urdhëroi peshkopët lokal që të riparonin për bashkësinë hebraike një sinagogë që ishte ndjegur nga turma e krishterëve në kufirin lindor të perandorisë. Ambrozi, në atë kohë peshkopi i Milanit e kërcënoi perandorin me shkishërim derisa ai e anuloi këtë urdhër. Ambrose, Ep. 40 dhe 41; shih F. H. Dudden, The Life and Times of St. Ambrose (Oxford, 1935), Vol. II, pp. 371-380. Në shekullin e V në Antioki në mënyrë të ngjashme edhe Simon Stylites e kërcënoi Teodosiusin e II kur ky i fundit kërkoi dëmshpërblim për plaçkitjen e një sinagoge. Codex Theodosianus, 16, 8, 25-6; Symeonis Stylitae Vita, XII.50.

[14] Një studim i mirë i kohëve të fundit është ai i Andrew Sharf, Byzantine Jeëry from Justinian to the Fourth Crusade (London: Routledge, and Kegan Paul 1971).

[15] See Ferdinand Gregorovius, The Ghetto and The Jews of Rome (Schocken, 1966).

[16] Një studim i shkëlqyer mbi emancipimin e hebrenjve është Jacob Katz, "Out of the Ghetto" (Harvard, 1973).

Date Created

22/09/2018

Author

rosemary-radford-reuther